



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
DREJTORIA E INTEGRIMIT EUROPIAN DHE INVESTIMEVE TË HUAJA

Nr. 1526 Prot

Vlorë, më 30.01 2024

PROCESVERBAL

KONSULTIM ME PUBLIKUN PËR TARIFAT PËR SHËRBIMET FUNERALE NË
BASHKINË VLORE

Data: 26.01.2024 ora 10.00
Vendi: Pallati i Kulturës "Labëria"

Baza ligjore: Në zbatim të ligjit nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" neni 18; ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", ligjit nr.146/2012 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1,2,3,4 neni 52; Rregullores e Organizimit dhe Funksionimit të Bashkisë.

Marrin pjesë:

Ermal Dredha-Kryetari i Bashkisë Vlorë, Elpiniqi Mërkuri-Kryetare e Këshillit Bashkiak, përfaqësues nga administrata e bashkisë, anëtarë të KB, përfaqësues nga komuniteti dhe media lokale.

Takimin e hapi Kryetarja e Këshillit Bashkiak të Vlorës znj.Elpiniqi Mërkuri: Përshendetje dhe ju falenderoj që jeni këtu për të diskutuar mbi tarifën e varrimit dhe zhvarrimit që do të parashikohen në buxhet. Dua t'ju njoftoj që në fillim se nuk ka ngritje të tarifave por ulje. Shërbimi ka qënë i menaxhuar nga një kompani private, kontrata është mbyllur dhe tani do të kalojë në administrimin e bashkisë këtë vit. Ju kërkoj ndjesë për kryetarin e bashkisë, do të na bashkohet pas pak në takim. Për sa i përket bazës ligjore është Projektvendimi me nr.96 datë 7.12.2023 që ka të bëjë me miratimin e taksave dhe tarifave vendore të buxhetit të bashkisë për vitin 2024 dhe kjo dëgjuesë vjen për të qënë korrekt me qytetarët. Do ja kalojë fjalën drejtoreshës për të dhënë sqarimet përkatëse.

Irena Toshkallari-nënkryetarja e Bashkisë Vlorë: Kjo dëgjese vjen si detyrim ligjor. Tarifat do miratohen nga bashkia dhe në konsultim me qytetarët.

Erinolda Lushaj- Drejtore e NSHP. Në zbatim të urdhrit të kryetarit, grupi i punës, ka analizuar tarifrat dhe cmimet. Tarifa e varrimit e cila përfshin punimet, gërmime me krahë, transporti me mjete, struktura monolite, beton, fuqinë punëtore dhe shpenzimet kapitale. Ka qënë 26 500 lek kur e menaxhonte kompania private dhe bëhet 21 670 lek te reja nën administrimin e bashkisë.

Edhe tarifa e zhvarrimit shkon në vlerën 16 124 mijë të reja e cila përfshin gërmimin e dheut, transportin, fuqinë punëtore, shpenzime operative dhe kapitale...

Tarifat e funeralit do të vendosen shtesë në VKB 96 të këshillit për tarifrat vendore për vitin 2024.

Ermal Dredha-Kryetar i Bashkisë Vlorë. Më falni për vonesën. Dua tju them që edhe pse ne krahasim me qytetet e tjera kemi tarifën me të ulët, përsëri donim të organizonim një dëgjese me ju, sikurse e kërkon ligji. Shërbimi ka qënë menaxhuar nga privati dhe do të administrohet nga ne tani. Nuk ka rritje të kostos. Shpresoj ta bëjmë mirë, ka ardhur momenti ta zgjidhim këtë punë. Shpresoj mos të kemi kontestim nga ana juaj por ta pranoni këtë që po diskutojmë sot.



*Konsultim me publikun për tarifrat për shërbimet
funerale në Bashkinë Vlorë*

Për më shumë konsultoni linkun

<https://fb.watch/pPzeDnViIU/?mibextid=v7YzmG>

Irena Toshkallari: Diskutime?

Sokol Kushta: anëtar i KB. Sot do flas si qytetar. S'ka njeri pa të afërm në varreza. Jam i zhgenjyer nga eprorët për sjelljen e tyre karshi të vdekurve. Ndryshimi është i madh tani. Ky është zhvillimi që ka marr Vlorë tani. Të kthehet në vend të pastër dhe të rregullt. Kam besim që për 6 muaj ka ndryshuar, por do të bëhet edhe më mirë. Unë jam mbështetës si qytetar edhe si këshilltar.

Agur Jazaj-Qytetar. Kam problem me ujin. Nuk na vjen. Shkova në ujësjellës dhe nuk u zgjidha. Është shqetësim sepse po e paguaj që nga 2010 deri në 2024.

Irena Toshkallari: Hajde në bashki ditën e hënë dhe do ta diskutojmë bashkë.

Naim Xhelilaj. Qytetar. Varoshi i gjyshit tim i cili ka qënë Dëshmor Atdheu. Është prishur varoshi, ka probleme struktura dhe unë e kam merak. Ai ka dhënë jetën për Atdheun.

Irena Toshkallari. Takoni drejtoreshën dhe e diskutoni.

Erinolda Lushaj: Po hajdeni dhe e sqarojmë.

Aleko Simoni-Qytetar. Bashkia ka marr në konsideratë këtë shqetësim dhe më bëhet qejfi. Varrezat na kanë lënë gjendje të keqe por ka përmirësime tani. Por rrugicat kanë akoma gropa. Duhet të merret përgjegjësi e plotë dhe të rregullohen. Firmat ikin dhe punët nuk bëhen. Për tarifatat nuk kam ankesë. Rrugicat të shtohen, të sistemohen, firma ta administroj sic duhet nëse do të bëj punën.

Ermal Dredha: Me kompaninë kishim ngërc ligjor. Menaxhimi është bërë. Ata kishin 30 vjet eksperiencë në menaxhim. Atyre ju mbaroi kontrata në shtator por ju kërkua kohë dhe bashkëpunim deri tani në fund të janarit, dhe në bashkërendim me ta sistemuam arkivën, dokumentacionin, hartat, si dhe do të shikojmë të shtojmë edhe territorin, sepse është në mbarim dhe do shikojmë për të gjetur territor tjetër përball apo në pjesën anësore, të shikojmë.. Maksimumi për 2-3muaj ka hapësirë aty me fluksin e humbjes së jetëve në qytet.

I takon bashkisë ta bëj mirë punën tani. Bashkia do shikoj parcelat, ndricimin, rrugicat. Kam dakortësuar me një biznesmen të qytetit i cili do të investoj, për ti bërë më mirë. Do diskutohet me komunitetin për hapsirat e zëna, do vendosim standart, hapsira për varoshin, distance nga njëri tjetri, ana estetike, jo me 2 e 3 kate. Tarifatat për varoshet me 2 kate do të jenë të ndryshme sipas kërkesës së familjarëve. Po kështu edhe për zhvarrimin. Menaxhimin do të bëjmë ne për fillim. Nëse do e bëjmë mirë në rregull apo nëse do ketë nevojë për bashkëpunim do ta shikojmë.

Qytetar: Ju falenderoj z.kryetar. ju kam parë present edhe në pastrimin e varrezave. Kam shpresë që do të rregullohet. Ashtu si duken edhe ndryshimet në qytet.

Qytetar: Probleme ka shumë kjo situatë, krematoriumi mund të jetë zgjidhje për sipërfaqen e varezave.

Qytetar: Keni besimin tonë, ju falenderojmë. Shtëpia e varimit duhet mirëmbajtur. Kam besim se do të bëhet nga ju shumë mire, kjo punë.

Qytetar: Më duket një reformë e madhe. Duhet akte dhe vendime të unifikuara edhe për pamjen atje, që të veprohet sipas rregullit, jo sipas salltaneteve. Kosto është e ulët. Jashtë është koncept ndryshe, tek ne kush të bëj varr më të madh. Kostot janë tamam.

Irena Toshkallari: Cështja u ezaurua dhe diksutimet do të merren në konsideratë. Tarifatat janë në rregull. Ju falenderoj për pjesëmarrjen!

Konceptoi: Albana Naçi

Koordinatorë për Njoftimin dhe Konsultimin Publik